



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:181891

Datë: 16.04.2024

Numri i dokumentit: 05579231

KF.nr.241/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar administrativ të paditësit “KMI” Sh.P.K, me numër unik të biznesit 810326539 dhe seli në fshatin Çagllavicë, Komuna e Graçanicës, të cilin me autorizim e përfaqëson Selim Nikqi avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Komuna e Gllogocit-Drenasit me adresë në rr. “Fehmi dhe Xhevë Lladrovci”, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulim të aktvendimit, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të mbajtur në prani të përfaqësuesit të palës paditës avokat Selim Nikqi dhe në mungesë të palës së paditur, me datë 08.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. Aprovohet kërkesëpadia e paditësit “KMI” Sh.P.K, me seli në fshatin Çagllavicë, Komuna e Graçanicës, si e bazuar.
- II. Anulohet Aktvendimi i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik të Komunës së Gllogocit me numër të protokollit 400/01-34758 i datës 28.07.2021.
- III. Mbetet në fuqi Aktvendimi nr. 04. Nr.114/17 i datës 04.10.2017 dhe aktvendim 04 nr.400-43128 i datës 26.07.2018 me të cilat është caktuar taksa për ushtrimin e veprimtarisë së paditëses në territorin e të paditurës për vitet 2017 dhe 2018 në shumë prej 250 Euro për vit, si dhe vërtetohet se paditësja e ka paguar taksën për ushtrimin e veprimtarisë së regjistruar në regjistrin e biznesit për vitet 2017 dhe 2018 dhe se nuk ka obligime ndaj të paditurës mbi këtë bazë.
- IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi “KMI” Sh.P.K, me seli në fshatin Çagllavicë, Komuna e Graçanicës, me padinë e paraqitur në Gjykatë me datë 18.08.2021, ka iniciuar kontest tregtar-administrativ kundër vendimit 05 nr.400/01-34758 të datës 28.07.2021 i Komunës së Drenasit-Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik me të cilin ka kërkuar të aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditëses KMI Sh.P.K., të anulohen si të kundërligjshme Aktvendimi i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik të Komunës së Glllogocit me numër të protokollit 400/01-34758 i datës 28.07.2021, ashtu që të mbeten në fuqi Aktvendimi në 04. Nr.114/17 i datës 04.10.2017 dhe 04 nr.400-43128 i datës 26.07.2018 me të cilat është caktuar taksa për ushtrimi e veprimtarisë së paditëses në territorin e të paditurës për vitet 2017 dhe 2018 në shumë prej 250 Euro për vit si the të vërtetohet se paditësja e ka paguar taksën për ushtrimin e veprimtarisë së regjistruar në regjistrin e biznesit për vitet 2017 dhe 2018 dhe se nuk ka obligime ndaj të paditurës mbi këtë bazë. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor-kryesor të datës 08.04.2024 dhe në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i palës paditëse ka deklaruar se edhe më tej mbeten pranë padisë, kërkesëpadisë si dhe parashtrimeve të theksuara si në procedurën që i ka paraprirë aktgjykimit të parë si dhe pranë atyre të paraqitura në seancën e datës 22.03.2024. Më tej ka shtuar se edhe një herë e sheh të nevojshëm të theksoj se e paditura me rastin e caktimit të taksës për ushtrimin e veprimtarisë për periudhën kontestuese është bazuar në nenin 3.1 të Rregullores Komonale për caktimin e taksave me të cilën parashihet taksa për veprimtarin Metalurgji e rëndë shkritore në të cilën kategori nuk bie paditësja. Kjo konfirmohet edhe me faktin se paditësja nuk figuron në regjistrin KPMM ku figuron Ferronikeli si metalurgji e rëndë, pra në këtë rast vendimi i të paditurës del të jetë i kundërligjshëm, prandaj edhe propozon që gjykata të veproj sipas kërkesëpadisë dhe të njëjtën ta aprovojë. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar edhe atë për hartimin e dy padive nga 208 €, për përgjigje në ankesë në shumë prej 208 € për përfaqësim në pesë seanca gjyqësore nga 270 € për seancë.

E paditura, në përgjigjen në padi të datës 17.11.2021, e kundërshton në të gjithë bazat kërkesëpadinë e paditësit. Ka theksuar se paditura Komuna e Glllogocit përkatësisht Drejtoria për Zhvillim Ekonomik me aktvendimin e datës 28.07.2021 me nr. protokollit 05-400/01-34758 sipas rekomandimit të Komisionit për shqyrtimin e ankesave, aktgjykimit A.nr.611/19 të datës 19.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative në rivendosje e ka anuluar sipas detyrës zyrtare aktvendimet 04-nr.114/17 të datës 04.10.2017 dhe aktvendimin 04-nr.400-43128 të datës 18.01.2019 mbi caktimin e Taksës Komonale për

ushtrimin e veprimtarisë në territorin e Komunës së Drenasit të Shoqërisë Tregtare “KMI” Sh.P.K. E paditura, në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 08.04.2024, edhe pse është ftuar në mënyrë të rregullt dhe ka pranuar ftesën për këtë seancë, nuk ka prezantuar duke e njoftuar Gjykatën me parashtrësën e datës 05.04.2024 se nuk do të merr pjesë në seancë, andaj edhe kërkon nga gjykata që të vepron në pajtim me nenin 423 paragrafi 4 të LPK-së. Gjithashtu ka kërkuar që të refuzohet padia dhe kërkesëpadija e paditësit si e pa bazuar dhe të mbetet në fuqi aktvendimi 05-400/01-34758 i datës 28.07.2021. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon. Rrjedhimisht Gjykata konform nenit 41 të LKA-së, e ka proceduar çështjen duke i lexuar parashtrësat e të paditurës.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 14.03.2024, ka administruar provat si në vijim: Aktvendimi nr. 400-43/28, Aktvendimi 400/01-3186, Aktvendimi 05-400-9865, Aktvendim 400-01-34758, Aktgjykim A.nr. 611/19, Aktvendim i trashëgimisë LRP.nr. 3379/2020, Kartelë financiare, Taksa për biznes, Vendim për leje mjedisore të integruar, Kërkesë e datës 30.01.2019, Njoftim i datës 05.02.2019, Parashtrësat e datës 16.02.2024, 21.03.2024 dhe 05.04.2024.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigjes në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar - administrativ, bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë kontest tregtar - administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga aktvendimi me nr. prot. 05-400-89865 i datës 20.02.2019 i Komunës së Drenasit Drejtoratit për Zhvillim Ekonomik gjykata e konstatoj faktin se e paditura Komuna e Drenasit-Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, në dispozitivin I ka anuluar sipas detyrës zyrtare aktvendimet; 04.nr.114/17 i datës 04.10.2017, 04 nr.400-43128 i datës 26.07.2018 dhe aktvendimin nr.400/01-3186 i datës 18.01.2019, mbi caktimin e taksës komunale për ushtrimin e veprimtarisë në territorin e Komunës së Glllogocit (Drenasit) të Shoqërisë Tregtare KMI SHPK me seli në Graçanicë, këtu paditësi, në dispozitivin e II ka caktuar taksën për ushtrimin e veprimtarisë afariste të paditësit në territorin e Komunës së Glllogocit, për vitin 2017 dhe 2018 në lartësi prej 140,000.00€, në dispozitivin e tretë të vendimit të kontestuar ka vendosur që pagesat e bëra nga paditësi sipas aktvendimeve të anuluar në lartësi prej 550,000.00€, do ti llogariten si pagesa të kryera në emër të taksës komunale duke zbritur shumën e paguar nga vlera e përgjithshme e

taksës sipas aktvendimit të ri, në dispozitivin e IV të vendimit ka detyruar paditësin që të paguaj shumën prej 139,750.00€, në emër të taksës komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste në territorin e Komunës së Drenasit për vitet 2017-2018, ndërsa në dispozitivin e V është vendosur që ankesa ndaj aktvendimit nuk e ndal ekzekutimin në kuptim të nenit 130 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Lidhur me padinë e paditësit të datës 11.03.2019, Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti Administrativ, Divizioni fiskal me datë 19.04.2021 ka marr aktvendimin A.nr.611/19 me të cilin ka anuluar vendimin e të paditurës 05-400-9865 të datës 20.02.2019 dhe lëndën e ka kthyer në rigjykim tek e paditura duke e obliguar të paditurën-Komisionin për Ankesa ndaj Taksës Komunale që në ri procedurë t'i shqyrtoj edhe njëherë pretendimet e palës të paraqitura në procedurë ankimore tek e paditura përmes ankesës së datës 21.01.2019, ashtu që e paditura duhet të deklarohet se çka është bërë me vendimin 04.nr.400-43128 të datës 26.07.2018 të Drejtoratit për Bujqësi dhe Zhvillim Ekonomik, me të cilin paditësit fillimisht i ishte caktuar taksa komunale në shumë prej 250.00€, për ushtrimin e veprimtarisë afariste në territorin e Komunës së Drenasit për vitin 2018, e të cilën taksë paditësi e kishte paguar me datë 06.02.2019. E paditura në ri procedurë duhet të deklarohet nëse paditësi për të njëjtën veprimtari afariste të ushtruar deri në vitin 2018 ka paguar taksën komunale në shumë prej 250.00€, nëse po atëherë si është e mundur që mbi bazën e rregullimeve të ngjashme ligjore me rregullore komunale për periudhën 2011-2018, e paditura paditësin ta ngarkoj me taksë komunale vjetore në shumë prej 250.00€, ndërsa pas kësaj periudhe ta ngarkoj me taksë në shumë prej 70.000.00€, për vit kalendarik. E paditura në rivendosje duhet ta vërtetoj faktin nëse veprimtaria e paditësit nga periudha 20.07.2017 prodhim dhe përpunim i metaleve sipas lejes mjedisore të integruar të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor nr.16/1067/ZSP/191 datë 12.07.2017 hynë në kategorinë “metalurgji e rëndë-shkritore” sipas nenit 13 të Rregullores Komunale 12 nr.30-19516 e datës 06.04.2018 për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha. E paditura duhet ti shqyrtoj edhe pretendimet tjera ankimore të paditësit të parashtruara në ankesën e datës 21.01.2019.

E paditura në riprocedurë ka nxjerr vendimin kontestues 400/01-34758 me datë 28.07.2021 ashtu që ka anuluar sipas detyrës zyrtare aktvendimet 04-nr.114/17 të datës 04.10.2017, dhe 04-nr.400-43128 të datës 18.01.2018 mbi caktimin e Taksë Komunale për ushtrimin e veprimtarisë në territorin e Komunës së Drenasit, dhe ka caktuar taksë për ushtrimin e veprimtarisë në territorin e Komunës së Drenasit për vitin 2017 në lartësi prej 60,000.00 € sipas

Rregullore nr.400-293 të datës 06.01.2015 për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha dhe për vitin 2018 ka caktuar taksë në lartësi prej 70, 000.00 € sipas Rregullores nr.030-19516 të datës 06.04.2018, për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha dhe ka detyruar paditësin të paguaj shumën prej 129,750 € në emër të Taksës Komunale për ushtrimin e veprimtarisë në Territorin e Komunës së Drenasit për vitet 2017 dhe 2018 në llogarinë e komunës.

Gjykata vlerëson se aktvendimi i kontestuar nuk ka bazë ligjore ashtu siç ka pretenduar e paditura, kjo për faktin se organi administrativ në rivendosje nuk i ka vlerësuar faktet vendimtare të çështjes lëndore, duke u bazuar në prova dhe ligj, ashtu që nuk e ka ndërlidhur mënyrën e vendosjes me dispozita konkrete ligjore dhe akteve komunale në fuqi, lidhur me caktimin e taksës komunale për veprimtarin që e ushtron paditësi, për periudhën e viteve 2017 dhe 2018, në lartësinë e cekur, gjer sa Rregullorja Komunale në të cilën bazohet organi i paditur me nr. 030-19516 dt. 06.04.2018, ka hyrë në fuqi prej datës 07.12.2018, (pas vlerësimit të ligjshmërisë së saj na MAPL). Me këtë Rregullore është shfuqizuar Rregullorja e Komunës së Glllogocit për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha komunale nr.01-031-9313 e datës 17.11.2010, si dhe të gjitha vendimet dhe plotësim ndryshimet e kësaj rregulloreje.

Me dispozitat e Rregullores në fjalë nuk provohet se e njëjta aplikohet për vitin 2018 dhe se pretendimin e paditësit se rregullorja nuk ka fuqi prapavepruese, kjo Gjykata e vlerëson si të bazuar, ashtu që konstaton se e paditura ka bërë shkeljen e ligjit në dëm të paditësit kur të njëjtin e ka ngarkuar me tatimin shtesë si në dispozitivin e të njëjtit, pavarësisht se e njëjta ka marr informatat nga MMPH dhe Administrata Tatimore lidhur me veprimtarinë e paditësit dhe qarkullimit vjetor, të cilat i ka marr si bazë për klasifikimin e paditëses në veprimtari afariste biznesore, përkatësisht me veprimtari Metalurgjia e rëndë- shkritore, për të cilat është parapara tarifa prej 70.000 euro. Gjykata vlerëson se cilado taksë që do ti caktohej paditëses për vitin kontestues 2018 në bazë të Rregullores 12 Nr.030-19516 të datës 06.04.2018, do të ishte kundërligjore, meqenëse siç edhe është sqaruar më lart, e njëjta nuk ka efekt prapaveprues dhe zbatueshmëria e saj është e vlefshme vetëm pas hyrjes në fuqi, respektivisht nga data 07.12.2018.

Ndërsa lidhur me taksën e caktuar në lartësi prej 60,000.00 euro për vitin 2017 në bazë të rregullores nr.400-293 të datës 06.01.2015, gjykata e pranon si të bazuar pretendimin e paditësit se në veprimtarin metalurgji e rëndë-shkritore, nuk bie paditësja, kjo për faktin se e paditura nuk ka dëshmuar me prova konkrete se si ka ardhur deri te ky vendim dhe se arsyetimi i të paditurës se faktin se paditësja mirët me prodhimin dhe përpunimin e metaleve e ka bazuar nga leja mjedisore e integruar nr.16/1067/YPS/191 e datës 12.07.2017 dhe nga procesverbali i drejtorisë së inspekcionit

komunal të Komunës së Drenasit me nr. 11/330-67591 i datës 12.18.2018 dhe me aktin e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor nr. 709/19 të datës 07.02.2019, dhe qarkullimin vjetor të marr nga Administrata Tatimore e Kosovës, gjykata nuk e pranon si të bazuar meqenëse e njëjta nuk ka vepruar konform rekomandimeve nga Gjykata me Aktgjykimin 611/19. Ministria e mjedisit dhe planifikimit hapësinor e ka theksuar se paditësja renditet në kategorinë *Prodhimi dhe Përpunimi i metaleve*, por kjo kategori nuk do të thotë se hyn në metalurgji të rëndë shkritore dhe se e paditura nuk e ka arsyetuar vendimin dhe nuk ka ofruar prova, siç ka qenë e obliguar.

Gjykata shqyrtoi vendimin kontestues, konform nenit 44 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative (LKA), me të cilin përcaktohet se” *Ligjshmëria e aktit administrativ të kontestuar shqyrtohet nga gjykata brenda kufijve të kërkesës nga padia, por nuk obligohet nga shkaqet e padisë. 2. Për nulitetin e aktit administrativ gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.*

Konform nenit 43 par 1 “*Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ, në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative*”, ndërsa sipas par 3 përcaktohet se“ *Nëse anulimi i aktit administrativ, sipas paragrafit 2. të këtij neni dhe zhvillimi i përsëritur i procedurës në organin administrativ kompetent do të shkaktonte për paditësin ndonjë dëm, i cili me vështirësi do të riparohej, apo nëse në bazë të dokumenteve zyrtare ose të provave të tjera në shkresat e lëndës është e qartë se gjendja faktike ndryshon nga ajo që është vërtetuar në procedurën administrative, apo nëse në të njëjtin konflikt administrativ është anuluar një herë akti administrativ, kurse organi administrativ kompetent nuk ka vepruar sipas aktgjykimit, gjykata mundet edhe vetë të vërtetojë gjendjen faktike ose me anë të organit tjetër dhe në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nxjerr aktgjykimin, respektivisht vendimin.*”

Rrjedhimisht, Gjykata vendosi se padia e paditësit është e bazuar ashtu që të njëjtën e aprovoi duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Gjykata sqaron se lidhur me pikën IV të dispozitivit të aktgjykimit *se vërtetohet se paditësja e ka paguar taksën për ushtrimin e veprimtarisë së regjistruar në regjistrin e biznesit për vitet 2017 dhe 2018 dhe se nuk ka obligime ndaj të paditurës*, e ka bazuar në vendimin kontestues i cili nuk ka kundërshtuar pagesën e taksës nga paditësja, për më shumë edhe vet e paditura në vendimin kontestues ka sqaruar se pagesat e bëra nga paditësja janë llogaritur si pagesa të kryera në emër të taksës komunale duke e zbritur shumën e paguar nga vlera e përgjithshme e taksës sipas aktvendimit të ri.

Gjykata i ka vlerësuar deklaratimet dhe provat tjera materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, por erdhi në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje juridike administrative.

Vendimin që secila palë ti bart shpenzimet e veta procedurale, Gjykata e mbështeti në nenin 64 të LKA-së.

Nga të lartcekurat, Gjykata konform nenit 43 par 1 dhe 46 par 2 dhe 4 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative , vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal
KF.nr.241/22 datë 08.04.2024

Gjyqtarja
Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.